

RREGULLORE E LEHTËSIMIT TË HYRJES NË RRJET TË
CENTRALEVE TË RINJ ELEKTRIKE ME KAPACITET TË
PËRGJITHSHËM JO MË TË MADH SE 5 MW

Neni 1

Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 42 pika 3 , të Ligjit Nr. 9072, datë 22.5.2003 « Për sektorin e energjisë elektrike », të ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Të sigurojë procedura të thjeshtuara për hyrjen në rrjet të centraleve të rinj elektrikë me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5MW.

Neni 3

Zbatimi

Kjo rregullore aplikohet për të gjithë të licensuarit që ndërtojnë dhe futin në shfrytëzim centrale të prodhimit të energjisë elektrike me kapacitet jo më të madh se 5 MW të cilët kërkojnë të realizojnë hyrjen në rrjet të centralit/eve.

Neni 4

Përcaktime

Në këtë rregullore termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin:

1. ERE do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike i cili është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike
2. Bordi i Komisionerëve është organi vendimmarrës i ERE-s , i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të legjislacionit në fuqi
3. I licensuar është personi mbajtës i një autorizimi të dhënë nga ERE për të operuar në prodhimin e energjisë elektrike nga centralet me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.
4. Central elektrik do të thotë një tërësi godinash me disa impiante të caktuara të cilat kanë si destinacion bazë gjenerimin e energjisë elektrike.
5. OSSH është personi i licensuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar aktualisht pjesë e KESH sh.a

KAPITULLI I DYTË

HYRJA NË RRJET

Neni 5

Kërkesa për hyrjen në rrjet

Çdo kërkesë nga një aplikues për hyrjen në rrjet të centraleve të rinj të prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet konform rregullave të parashikuara në Kodin e Funksionimit të Shpërndarjes.

Neni 6

Hyrja në rrjet

1. OSSH do të shqyrtojë dhe marrë vendim për miratimin e pikës së lidhjes në rrjet të centralit elektrik. brenda 30 ditëve nga marrja e një aplikimi të rregullt.
2. Mbas miratimit të pikës së lidhjes në rrjet të centralit elektrik, OSSH do të realizojë hyrjen në rrjet të centralit elektrik jo më vonë se 45 ditë pas njoftimit me shkrim në OSSH nga i licensuari për përfundimin e të gjithë punimeve në central.

KAPITULLI I TRETË

DISPOZITA FINALE

Neni 7

Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Këto Rregulla hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.